

2021

RAPORTI I
VEPRIMTARISË

KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

Adresa Rr "Reshit Çollaku", Tiranë
www.kkk.gov.al tel 04 220 499/466
NIPT K 62418013 P



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT

Adresa: Rr "Reshit Çollaku"/ Pranë ILDKP, Tiranë
Tel: 042 220 466 / 99 Site: www.kkk.gov.al E_mail: kontabiliteti@kkk.gov.al

RAPORTI
i
VEPRIMTARISË

Viti 2021

Mars 2022

P Ë R M B A J T J A

1. Hyrje

2. Aktivitetet kryesore të vitit 2021

3. Informacion i detajuar mbi detyrat e realizuara në vitin 2021

- *Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar*
- *Standardet Kombëtare të Kontabilitetit*
- *Detyra të tjera:*
 - *ngarkuar nga Këshilli*
 - *në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Raportimin Financiar në Shqipëri*

4. Plani i punës për vitin 2022

Shtojcë A - Realizimi i treguesve të buxhetit 2021

Shtojcë B - Buxheti i planifikuar për vitin 2022

Shtojcë C – Pasqyrat financiare 2021

SHKURTIME

| | |
|------|--|
| AAJM | Aktive Afatgjata Jomateriale |
| AAM | Aktive Afatgjata Materiale |
| BE | Bashkimi European |
| BMP | Bordi i Mbikqyrjes Publike |
| BSNK | Bordi i Standardeve të Kontabilitetit |
| IAL | Institucionet e Arsimit të Lartë |
| IEKA | Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar |
| IKM | Instituti i Kontabilistëve të Miratuar |
| KKK | Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit |
| MEPJ | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| NVM | Njësi ekonomike të Vogla dhe të Mesme |
| OJF | Organizata Jo Fitimprurëse |
| PKIE | Plani Kombëtar për Integrimin European |
| QKB | Qendra Kombëtare e Biznesit |
| SKK | Standardet Kombëtare të Kontabilitetit |
| SNK | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit |
| SNRF | Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar |

1. Hyrje

Në mbledhjen e parë të vitit, Këshilli miratoi programin e punës për vitin 2021. Programi i hartuar synon përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga akte ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat rregullojnë organizimin dhe funksionimin e KKK-së. Gjithashtu programi është në përputhje me misionin publik të KKK-së si standard hartues në fushën e raportimit financiar.

Detyrat e parashikuara në planin e punës, sipas muajve përkatës, kanë qenë pjesë e rendit të ditës së mbledhjeve të organizuara gjatë vitit 2021.

2. Detyrat e realizuara në vitin 2021

Detyrat për vitin 2021, miratuar nga KKK-ja në mbledhjen e parë të vitit 2021 dhe statusi i realizimit të tyre, paraqiten si më poshtë:

| DETYRAT | Statusi i realizimit | Nr | Periudha |
|---|----------------------|----|----------|
| • Analiza e veprimtarisë dhe buxhetit për vitin 2020; | Realizuar | 1 | 22 Janar |
| • Diskutimi dhe miratimi i Draft programit të punës për vitin 2021; | Realizuar | | |
| • Draft axhenda e aktivitetit me IAL-të; | Realizuar | | |
| • Përgatitja e ndryshimeve të referencave ligjore të SKK-ve; | Realizuar | | |
| • Diskutimi dhe miratimi i Raportit Vjetor; | Realizuar | 2 | 26 Mars |
| • Rishikimi i Udhëzuesit të SKK 6; | Realizuar | | |
| • Rishikimi i shënimeve shpjeguese të SKK 15; | Realizuar | | |
| • Diskutimi dhe miratimi për publikim i check list; | Në pritje | | |
| • Rishikimi i Udhëzuesit të SKK 8; | Realizuar | 3 | 7 Maj |

| | | | |
|--|--------------------------|----|---------------|
| <ul style="list-style-type: none"> Analiza e përfundimeve të takimit me IAL-të; | Realizuar | | |
| <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i shënimeve shpjeguese për SKK 1 dhe SKK 2; | Realizuar | | |
| <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i Udhëzuesit të SKK 10; | Realizuar | 4 | 28 Maj |
| <ul style="list-style-type: none"> Miratimi për publikim i variantit të konsoliduar të SKK 2 dhe SKK 9; | Realizuar | | |
| <ul style="list-style-type: none"> Diskutimi për draftin e rishikuar të SKK1 (paragrafët 120-129); | Realizuar | | |
| <ul style="list-style-type: none"> Diskutimi mbi draft marrëveshjen me BMP | Realizuar | | |
| <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i Udhëzuesit të SKK 12; | Realizuar | 5 | 11 Qershor |
| <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja për publikim e variantit të konsoliduar të SKK-ve (3, 5, 11 dhe 13) përfshirë ndryshimin e referencave ligjore; | Realizuar | | |
| <ul style="list-style-type: none"> Miratimi i ndryshimeve të shënimeve shpjeguese SKK 1 – SKK 15 | Realizuar | | |
| <ul style="list-style-type: none"> Miratimi dhe publikimi i variantit të konsoliduar të SNRF-ve, të publikuara deri në vitin 2020; | Realizuar | 6 | 30 Qershor |
| <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i Udhëzuesit të SKK 14; | Realizuar | | |
| <ul style="list-style-type: none"> Analiza e veprimtarisë për 6 mujorin I-rë 2021 | Realizuar | 7 | 16 Korrik |
| <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i Udhëzuesit të SKK 3, Seksioni i parë; | Realizuar | 8 | 28 Shtator |
| <ul style="list-style-type: none"> Takim online me PAO-të; | Zëvendësuar me Simpozium | | |
| <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i Udhëzuesit të SKK 11; | Realizuar | 9 | 22 Tetor |
| <ul style="list-style-type: none"> Rishikimi i Udhëzuesit të SKK 3, Seksioni i dytë; | Realizuar | 10 | 16 Nëntor |
| <ul style="list-style-type: none"> Simpoziumi “Pandemia dhe Fiskalizimi” - <i>Impakti i këtyre ngjarjeve në cilësinë e raportimit financiar të kompanive shqiptare</i> | Realizuar | 11 | 6 – 7 Dhjetor |
| <ul style="list-style-type: none"> Fjalorthi për Udhëzuesin e SKK 3, Seksioni i dytë; Përmbledhje e përfundimeve të Simpoziumit; Draft programi i punës për vitin 2022; | Realizuar | 12 | Dhjetor |

Një përmbledhje e aktiviteteve dhe detyrave të përmbushura është si mëposhtë:

- Varianti i konsoliduar 2021 i SNRF-ve
- Varianti i konsoliduar 2021 i SKK-ve (përfshirë ndryshimet për bazën ligjore dhe ndryshime të tjera të miratuara në vitet 2019-2020
- Miratimi i ndryshimeve të shënimeve shpjeguese të SKK-ve
- Udhëzuesit e rishikuar të 14 SKK-ve – Drafti i parë
- Takimi me IAL-të;
- Simpozium “Pandemia dhe Fiskalizimi”

Të tjera detyra të realizuara gjatë kësaj periudhe nga stafi i KKK-së janë:

1. Koordinimi i punës për përkthimin e ndryshimeve 2021 të SNRF-ve, paraqitja për miratim në Këshill dhe përgatitja e dosjes shoqëruese në dërgimin e tyre për shpallje nga Ministri i Financave;
2. Raportimi periodik për Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme (mbi informacionet e kërkuara nga Shërbimet e Komisionit European për Kapitullin 6 *Ligji Tregtar*);
3. Raportimi periodik për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me realizimin e detyrave institucionale dhe përfshirjen e tyre në kontributin për progres raportin e Shqipërisë;

3. Informacion i detajuar mbi detyrat e realizuara

Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar

a) Përkthimi i SNRF-ve

Në muajt e parë të vitit janë përkthyer, rishikuar, miratuar në KKK dhe shpallur për zbatim me Urdhër Nr. 96, datë 25.05.2021, Urdhër Nr.101, datë 25.05.2021, Urdhër Nr.164, datë 08.09.2021, Urdhër Nr.29, datë 01.02.2022 të Ministrisë përgjegjëse për financat, materialet e publikuara nga BSNK gjatë vitit 2021, si më poshtë:

| Titulli | Data Efektive | Urdhri i Ministrit të MFE-së |
|--|----------------------|-------------------------------------|
| 50768_EN_GVT_Amend_IAS_1 <i>Paraqitja e Pasqyrave Financiare</i> Ndryshime të SNK _1 | Më 1 janar 2023 | Urdhër Nr. 96, datë 25.05.2021 |
| 69411_AL_GVT_Amend_IAS_8 <i>Politikat kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet</i> Ndryshime të SNK _8 | Më 1 janar 2023 | Urdhër Nr. 96, datë 25.05.2021 |
| 69958_EN_GVT_Amend_IFRS_16 <i>Koncesionet e Qirave të Lidhura me Covid-19 pas 30 qershorit 2021</i> Ndryshime të SNRF16 | Më 1 prill 2021 | Urdhër Nr.101, datë 25.05.2021 |
| 77544_AL_GVT_Amend_IAS_12 <i>Tatimi i shtyrë në lidhje me aktive dhe detyrime që rrjedhin nga një transaksion i vetëm</i> Ndryshime në SNK 12 | Më 1 janar 2023 | Urdhër Nr.164, datë 08.09.2021 |
| 2202_AL_GVT_Amend_IFRS_17_Dec_2021 <i>Zbatimi për herë të parë i SNRF 17 dhe SNRF 9—Informacioni krahasues</i> Ndryshime në SNRF 17 | Më 1 janar 2023 | Urdhër Nr.29, datë 01.02.2022 |

b) Përgatitja e variantit të konsoliduar të SNRF-ve

Në 8 prill 2021, BSNK në përputhje me termat e kontratës, dërgoi materialin *Red Book 2021*. Inspektori i ngarkuar për përgatitjen e variantit të konsoliduar filloi menjëherë nga puna për përgatitjen e variantit të konsoliduar 2021 të SNRF-ve në gjuhën shqipe, përmes programit TRADOS.

Si procedurë, në variantin e konsoliduar të vitit 2021 përfshihen SNRF-të e publikuara nga BSNK deri në dhjetor të vitit 2020. Varianti i konsoliduar 2021 përfundoi brenda muajit qershor dhe u dërgua për aprovim në BSNK. Me përjashtim të një ndërhyrje në formatimin e një tabele, gjithçka tjetër ishte në përputhje me kriteret e përcaktuara nga BSNK për publikimin e materialit. Konfirmimi erdhi me email përpara mbledhjes së datës 30 qershor. Varianti i konsoliduar 2021 është publikuar në faqen e internetit të KKK-së në linkun:

<https://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=135&gj=sh>.

Standardet kombëtare të kontabilitetit

a) Rishikimi i shënimeve shpjeguese

Në kuadër të plotësimit të rekomandimeve të KE për çështjet e transpozimit të Direktivave të BE, ka vijuar puna për rishikimin e shënimeve shpjeguese edhe të standardeve të tjera përveç atyre që përfunduan gjatë vitit 2020. Rishikimi konsiston në thjeshtimin e shënimeve shpjeguese të NjVM në masën e parashikuar në Dir 34/2013 EU, nenin 16 *Përmbajtja e shënimeve shpjeguese për të gjitha njësitë ekonomike*¹ dhe nenin 17 *Shënime shpjeguese shtesë për njësitë e mesme, të mëdha dhe ato me interes publik*² të Direktivës 34/2013/EU, ndryshuar me Direktivën 95/2014/EU.

Në 6-mujorin e parë u miratuan shënimet shpjeguese të SKK1, SKK2 dhe SKK15, të cilat përmbyllën rishikimin e plotë të të gjitha standardeve kombëtare në pjesën e shënimeve shpjeguese. Me vendimin qarkullues Vendim nr 5, datë 07.07.2021 u vendos që ndryshimet e SKK-ve (shënimet shpjeguese të NjVM-ve) të publikohen për komente për një periudhë tre mujore. Me përfundimin e afatit për komente, Këshilli, mbështetur në rregulloren e organizimit dhe funksionimit, vendosi të shtyjë edhe me tre muaj të tjerë afatin e publikimit për komente, afat i cili përfundoi në 10 janar 2022, datë mbas të cilës ky material u dërgua për shpallje nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Materialet janë të publikuar në linkun:

http://kkk.gov.al/foto/uploads/File/Ndryshime%20ne%20shenimet%20shpjeguese%20te%20SKKve_te%20publikuara.pdf

¹ **Article 16 (3) Content of the notes to the financial statements relating to all undertakings**

Member States SHALL NOT REQUIRE disclosure for small undertakings beyond what is required or permitted by this Article.

² **Article 16 (2) Content of the notes to the financial statements relating to all undertakings**

Member States may require mutatis mutandis that small undertakings are to disclose information as required in points (a), (m), (p), (q) and (r) of Article 17(1).

b) Rishikimi i udhëzuesve të SKK-ve

Në programin e punës 2021 ishte parashikuar të vijohej me përmirësimin e udhëzuesve të SKK-ve të tjera përveç atyre të rishikuar gjatë vitit 2020. Konkretisht është rishikuar udhëzuesi për SKK6 *Provizionet*, SKK8 *Të ardhurat*, SKK10 *Grantet*, SKK12 *Efektet e kurseve të këmbimit*, SKK14 *Investimet e përbashkëta dhe sipërmarrjet e përbashkëta*, SKK 11 *Tatimi mbi të ardhurat*, SKK 3 *Instrumentet financiare* (seksioni i parë) ndërsa është hartuar për herë të parë Udhëzuesi për SKK 3 *Instrumentet financiare*, seksioni i dytë.

Metodologjia e ndjekur për përmirësimin e Udhëzuesve konsiston në: (1) përmirësimin e materialit ekzistues, duke korrigjuar të gjitha problematikat e konstatuara në vitet e zbatimit të këtyre udhëzuesve dhe (2) pasurimin e udhëzuesve me shpjegime, ilustrime dhe ushtrime të reja.

Faza e parë e rishikimit ka përfunduar. Faza e dytë, e shtrirë përgjatë vitit 2022, do të konsistojë në diskutimin e këtyre udhëzuesve draft me palët e interesit (shoqatat e profesionit dhe akademikët) duke vlerësuar rast pas rasti komentet e tyre me qëllim reflektimin e sugjerimeve të palëve të interesit dhe të miratuara në Këshill, në tekstet e Udhëzuesve të SKK-ve.

c) Ndryshime 2021 të SKK -ve

Në fillim të vitit 2021, është punuar për ndryshimin e referencave ligjore të SKK-ve, për të reflektuar ligjin e ri të miratuar të kontabilitetit, Ligji nr 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Ndryshimi preku të gjitha SKK-të.

Urdhri për shpalljen e detyrueshme për zbatim të këtij ndryshimi është publikuar në Fletoren Zyrtare Nr 120, datë 30.07.2021. Me botimin e Urdhrit nr 34, datë 21.07.2021 në Fletoren Zyrtare, ndryshimet e miratuara u publikuan në faqen e internetit të KKK-së së bashku me Urdhrin e shpalljes. Publikimi në faqen e internetit të ndryshimeve në track changes, bëhet me qëllim që informacioni për ndryshimet të jetë lehtësisht i kuptueshëm nga përdoruesit e SKK-ve.

<https://kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=166&gj=sh>

d) Përgatitja e variantit të konsoliduar 2021 të SKK-ve

Në vitet 2019-2021, disa nga SKK-të (SKK2 *Paraqitja e pasqyrave financiare*, SKK9 *Kombinimi i bizneseve dhe konsolidimi*, SKK3 *Instrumentet financiare*, SKK5 *Aktivët afatgjatë materiale dhe jomateriale*, SKK11 *Tatimi mbi të ardhurat* dhe SKK13 *Aktivët biologjike dhe marrëveshjet koncesionare*) janë ndryshuar për të reflektuar zhvillimet e ndodhura në kuadrin vendas dhe atë ndërkombëtar të raportimit financiar të korporatave. Me qëllim lehtësimin për përdoruesit të kuptueshmërisë të SKK-ve, Këshilli gjatë vitit 2021 përgatiti variantin e konsoliduar të SKK-ve i cili përmban variantin bazë të SKK të përmirësuara (2015) dhe të gjitha ndryshimet e miratuara dhe të shpallura për zbatim në vitet 2019-2021. Varianti i konsoliduar është publikuar në linkun:

<https://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=166&gj=sh>.

Për konsolidimin e SKK-ve me të gjitha ndryshimet e miratuara, procedura e ndjekur do të jetë e njëjtë me atë të BSNK-së. Nëse gjatë viti miratohen dhe shpallen ndryshime të SKK-ve, brenda 6 mujorit të parë të vitit pasardhës do të publikohet varianti i konsoliduar.

e) Simpoziumi “Pandemia dhe Fiskalizimi”

Në aktivitetin e zhvilluar në datë 7 dhjetor 2021, me temë “Pandemia dhe fiskalizimi-Ndikimi i këtyre ngjarjeve në cilësinë e raportimit financiar” morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të organizatave të profesionit, kontabilistë dhe auditues, akademikë dhe të tjerë të ftuar. Diskutimet prekën dy çështjet kryesore për të cilat u organizua aktiviteti. Ra në sy një mungesë reflektimi e përgjithshme nga ana e profesionistëve për të vlerësuar ndikimin e efekteve të pandemisë në raportimet e tyre financiare. Më së shumti interesimi i tyre u vërejt në drejtim të konsiderimit të efekteve të fiskalizimit në kontabilitetin dhe raportimin e njësisve ekonomike. Megjithatë, diskutimet shkuan përtej, duke ngritur disa problematika që zgjidhjen mund ta marrin vetëm nëse ka një bashkëpunim dhe bashkërendim mes institucioneve dhe autoriteteve publike përgjegjëse për çështjet e raportimit financiar.

U ngritën me forcë disa probleme si më poshtë:

- rastet e paligjshmërisë kur individë jo profesionistë marrin përsipër hartimin e pasqyrave financiare;
- rastet kur bizneset “këshillohen” gabim të mos publikojnë pasqyra ekonomike deri në një kufi të sipërm të ndryshëm nga ai i parashikuar në ligjin për kontabilitetin;
- qasja e raportimit financiar drejt rregullimeve fiskale dhe jo parimeve të SKK-ve (kryesisht vërehet ky fenomen tek bizneset e vogla dhe të mesme)
- mungesa e shënimeve shpjeguese cilësore (sikurse dhe mos përgatitja e tyre)

Në fund të aktivitetit, Këshilli mori angazhimin që të komunikojë dhe të bashkëpunojë edhe me Institucionet e tjera si DPT dhe QKB për të qartësuar seriozitetin e problematikave të ngritura nga diskutantët e më pas puna të orientohet për zgjidhjet përkatëse të tyre.

Detyra të tjera

➤ Raporti i veprimtarisë 2020;

a) Raporti i veprimtarisë 2020. Në ligjin e kontabilitetit, neni 27(1) dhe 27(2) parashikohet që Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit raporton me shkrim pranë ministrit përgjegjës për financat, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, në lidhje me veprimtarinë vjetore të tij. Raporti, pjesa ku trajtohen me hollësi problemet e konstatuara gjatë monitorimeve në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe zgjidhjet e sugjeruara, i dërgohet për informacion Bordit të Mbikëqyrjes Publike, brenda afatit të pikës 1, të këtij neni.

Raporti i veprimtarisë 2020 u miratua në Këshill për t’u dëguar, brenda të gjitha afateve, tek ministri përgjegjës për financat dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Gjithashtu raporti i veprimtarisë u publikua në faqen e internetit të KKK-së.

https://kkk.gov.al/foto/uploads/File/Raporti%20Vjetor%20i%20Veprimtarise%202020_i%20publikuar.pdf

➤ *Gjetjet nga monitorimi i pasqyrave financiare për vitin 2021*

Gjatë vitit 2021, në zbatim të kërkesës së ligjit 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” janë monitoruar pasqyrat financiare të 50 njësive ekonomike. Pasqyrat financiare janë siguruar nga faqja zyrtare e QKB-së. Përzgjedhja e njësive ekonomike bëhet në mënyrë të rastësishme.

Pasqyrat e monitoruara në periudhën Janar-Dhjetor 2021

Në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur përfundimet e dala nga monitorimi i Pasqyrave Financiare për periudhën Janar - Dhjetor, të marra nga portali i QKB-së. Pasqyrat e monitoruara mbulojnë raportimin financiar të viteve 2019 - 2020.

Gjithsej janë audituar 50(pesëdhjetë) njësi ekonomike, 6(gjashtë) prej të cilave nuk kanë i kanë publikuar pasqyrat e tyre financiare (8.3% e njësive). Nga këto 4(katër) njësi ekonomike janë mikro, 27(njëzeteshtatë) njësi ekonomike janë të vogla, 8(tetë) njësi ekonomike janë të mesme dhe 5(pesë) njësi ekonomike janë të mëdha.

Problematikat e hasura gjatë monitorimit:

Raporti i Auditit

Nga të dhënat e publikuara rezulton që **19 (nëntëmbëdhjetë) njësi** ekonomike plotësojnë kushtin për auditim. Ndër to:

- **5(pesë)** kanë të publikuar raportin e auditimit (4 njësi janë me SNRF dhe 1 prej tyre me SKK)
- **1(një)** njësi ekonomike nuk ka publikuar raportin se është në proces gjyqësor (harton pasqyra me SNRF);
- **13(trembëdhjetë)** njësi ekonomike nuk e kanë të shfaqur në QKB raportin e auditimit;

31 (tridhjetënjë) njësitë e tjera nuk e kanë të publikuar këtë raport pasi nuk plotësojnë kushtet për auditimin e pasqyrave financiare. Mbetet një rezervë në vlerësim për 6 prej tyre pasi nuk kanë dhënë numrin e punonjësve në shënimet shpjeguese.

Vërehet si mangësi e përgjithshme fakti që në të gjitha shënimet shpjeguese të publikuara, njësitë që kanë plotësuar kushtin për auditim, nuk janë shprehur për pagesën e auditimit ligjor në përputhje me kërkesën e parashikuar në ligjin e kontabilitetit.

Raportet e tjera që kërkohen sipas ligjit

Njësitë ekonomike që hartojnë pasqyra me SNRF janë gjithsej pesë, por vetëm 3 prej tyre i kanë të gjitha raportet e tjera që shoqërojnë pasqyrat financiare. Njësia ekonomike e katërt ka të publikuar vetëm raportin e ecurisë së veprimtarisë. Ndërsa njësia e pestë nuk ka publikuar raportin jofinanciar.

Ndër njësitë ekonomike që hartojnë pasqyra sipas SKK-ve, ku 8(tetë) prej tyre kanë detyrimin të publikojnë raportin e ecurisë, vetëm 3(tre) e kanë plotësuar këtë kërkesë të ligjit.

Standardet e aplikueshme

Nga **44(dyzetekatër)** njësitë ekonomike që i kanë të publikuara pasqyrat, **5(pesë)** njësi zbatojnë SNRF-të dhe **39(tridhjetëenëntë)** njësi ekonomike zbatojnë SKK-të.

Shënimet shpjeguese

6 (gjashtë) njësi nuk kanë pasqyra të publikuara

3 (tre) njësi nuk kanë farë të publikuara shënime shpjeguese,

37 (tridhjetë e shtatë) njësi ekonomike kanë publikuar në pdf sërish pasqyrat me ndonjë shpjegim narrativ të varfër të të dhënave të pasqyrave por asgjë nga kërkesat që parashikojnë shënimet shpjeguese të SKK-ve

4 (katër) njësi ekonomike i kanë shënimet shpjeguese me detaje sipas standardeve.

Problematikat e konstatuara janë evidentuar si më poshtë:

- **1(një)** njësi ekonomike ka diferenca midis zërave të pasqyrës së pozicionit dhe shënimeve shpjeguese;

- **4(katër)** njësi ekonomike janë shoqëri me ortakë, në shënimet shpjeguese mungojnë informacionet mbi kapitalin aksionier të shoqërisë;
- Në të gjitha njësitë që kanë marrë hua mungon informacioni mbi shumën e huasë, pagesën, grafikun e shlyerjes, interesin, kolateralin dhe riskun e mosshlyerjes;
- Në **70 %** të shoqërive të kontrolluara mungon informacioni në shpjegimet shpjeguese mbi politikat kontabël të mbajtjes së inventarit, vlerën me të cilën inventari është paraqitur në pasqyra, vlerën e inventarit të konsumuar dhe gjendjen e tij në fund të vitit;
- Në **85 %** të njësive ekonomike të kontrolluara mungon informacioni në shënimet shpjeguese për aktivet afatgjata, për politikat kontabël të matjes dhe vlerësimit të tyre të mëpasshëm, llogaritja e amortizimit apo nëse ka patur zhvlerësim apo tregues të zhvlerësimit;
- Vetëm **2(dy)** njësi ekonomike kanë sqaruar pagat e personelit sipas kategorive;
- **1(një)** njësi ekonomike ka shpenzime avokatie, por në shënimet shpjeguese nuk jepet asnjë info në lidhje me çështjen/t gjyqore, pritshmëritë e përfundimit në lidhje me afatet apo shumat për t'u paguar;
- **2(dy)** njësi ekonomike kanë marrë aktive afatgjata me Qira financiare, por në shënimet shpjeguese nuk ka informacion të plotë mbi kontratën, pagesat minimale të qirasë, detyrimin afatshkurtër dhe afatgjatë të kësaj kontrate, normën e aktualizimit të PMQ-ve, etj;
- Në të gjitha njësitë e kontrolluara nuk ka info në lidhje me klientët e paarkëtueshëm ose në lidhje me ditë vonesat në arkëtimet e tyre;
- Nuk ka informacion në shënime në lidhje me Furnitorët, nuk ka info në lidhje me likuidimin e tyre, si dhe klasifikimin e tyre në afatshkurtër apo afatgjatë;

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Nga njësitë e monitoruara, të gjitha njësitë ekonomike që kanë detyrimin të hartojnë dhe publikojnë pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse e kanë përmbushur këtë detyrim, por të gjitha njësitë kanë të plotësuar vetëm zërin fitim/humbje të vitit dhe nuk kanë të plotësuar zërat e tjerë. Kjo situatë krijon një rezervë lidhur me cilësinë e paraqitjes së pasqyrave financiare.

Numri i punonjësve

9 (nëntë) njësi ekonomike e kanë dhënë në shënime numrin e punonjësve.

Të tjera në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Raportimin Financiar në Shqipëri

a) Marrëveshjet e bashkëpunimit.

Janë përgatitur draft Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Institucionet publike

1. Qendra Kombëtare e Biznesit
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
3. Bordi i Mbikqyrjes Publike

Draft aktet do të konsultohen dhe me specialistë të tjerë të fushës jashtë KKK-së dhe në një moment të përshtatshëm do të fillojnë diskutimet me Institucionet e përmendura më sipër për të përfunduar në firmosjen e këtyre akteve të bashkëpunimit ndër-institucional.

b) Bashkëpunimi me IAL-të për kurikulat universitare në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Në datë 15 prill 2021, është organizuar takimi online me përfaqësues të IAL-ve publike dhe private. Pjesëmarrja në takim ishte një tregues i interesit të lartë që kanë këto institucione për të bashkëpunuar me KKK-në në disa drejtime. Takimi shërbeu jo vetëm si një platformë prezantimi për rolin dhe detyrat e KKK-së apo fushat e mundshme të bashkëpunimit që KKK ofron por gjithashtu dhe si një mundësi e mirë për të ndarë me akademikët dhe drejtuesit e këtyre Institucioneve disa zhvillime ndërkombëtare në fushën e raportimit financiar, përfshirë dhe kërkesat për kurikulat universitare.

Nga takimi u dakordësua që të ngrihej një grup pune i cili më pas do të koordinonte veprimet mes IAL-ve dhe KKK-ve mbi baza periodike por edhe për tematika apo problematika të veçanta. Një nga çështjet që mori përparësi është rishikimi i kurikulave universitare në dritën e IES 2 “Standardi Ndërkombëtar i Edukimit” për të parë mundësinë e përmirësimit të mëtejshëm të tyre.

KKK është angazhuar të jetë pjesë e këtij procesi vlerësimi të kurikulave.

Raportime për MFE dhe MEPJ

Një nga detyrat funksionale të stafit të KKK-së është raportimi i vijueshëm, pranë Ministrisë përgjegjëse për financat dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për detyrat e realizuara/të planifikuara/të parashikuara, kryesisht për ato që burojnë nga detyrimi për respektimin e MSA³-së dhe PKIE⁴-së.

Rregullisht mbi baza tremujore, raportohet në MFE në kuadër të përgatitjes së progres raportit të Qeverisë Shqiptare në procesin e integritimit në Bashkimin Europian. Raportohen aktivitete, produkte, akte të miratuara të cilat janë në përputhje me PKIE dhe dëshmojnë hapa drejt harmonizimit /transpozimit të legjislacionit europian. KKK është një nga Institucionet e përfshira në plotësimin e informacionit për *Screening List / Legal Gap Analysis of Chapter 6* ku raportohen të gjitha aktet ligjore, nënligjore dhe të tjera në zbatim të tyre, të cilat kanë transpozuar hard dhe soft Acquis që mbulojnë çështjet e kontabilitetit dhe raportimit.

Ndërsa raportimi për MEPJ kryesisht është i bazuar në adresimin e pyetjeve që vijnë për KKK-në nga negociatori i Shërbimeve të Komisionit Europian. Sërish interesimi i Shërbimeve të Komisionit Europian është i fokusuar në plotësimin e detyrave që i janë lënë Institucioneve të vendit në Raport Progresin e përgatitur nga KE për periudhën/at e mëparshme.

Në kuadër të angazhimit “Qeverisja në 100 ditë dhe pritshmëritë në 2022”, Këshillit i’u kërkua plotësimi i matricës së raportimit të objektivave, çështjeve, nënçështjeve, afateve dhe zbatueshmërisë së tyre. Materiali i dorëzuar është paraqitur më poshtë:

³ MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

⁴ PKIE – Plani Kombëtar për Integrimin Europian

| OBJEKTIVI KRYESOR | PERSHKRIMI I OBJEKTIVIT | AFATI | NENÇESHTJET | AFATI NENÇESHTJEVE | PER MBESHTETJE | BASHKEPUNIMI ME INSTITUCIONE TE TJERA |
|---|--|--------------|--|--------------------|----------------|---------------------------------------|
| Përmirësimi i raportimit financiar të korporatave | Ndryshimi i VKM 17, datë 16.01.2019 "PËR PËRCAKTIMIN E SHOQËRIVE TË TJERA SHTETËRORE OSE PRIVATE, TË RËNDËSISHME PËR INTERESIN E PUBLIKUT, PËR SHKAK TË NATYRËS SË BIZNESIT, MADHËSISË OSE NUMRIT TË PUNËMARRËSVE TË TYRE" për përditësimin e kriterëve sasiore të klasifikimit të njësisve me interes publik (në zbatim të ligjit për kontabilitetin) | Mars 2022 | Dërgimi në MFE VKM 17, datë 16.01.2019 propozimin për ndryshime të akteve nënligjore | Janar 2022 | | MFE, BMP |
| | Krijimi i një sistemi raportimi unik të PF, sistem i cili do të lejojë ushtrimin e përgjegjësive të KKK dhe DPT lidhur me zbatimin e SKK/SNK-ve dhe legjislacionit tatimor | Shtator 2022 | 1. Koordinimi i punës me institucionet dhe strukturat përkatëse në realizimin e këtyre objektivave 2. Draftimi i propozimeve për ndryshime të akteve ligjore/nënligjore | Qershor 2022 | | QKB dhe DPT |
| | Forcimi i legjislacionit për raportimin financiar | Qershor 2022 | 1. Ndryshime ligjore dhe miratim i akteve nënligjore që krijojnë një sistem të qendrueshëm të identifikimit dhe kontrollit të personit përgjegjës për hartimin e PF-ve (në përputhje me sa parashikohet në ligjin e kontabilitetit). 2. Koordinimi i punës me institucionet dhe strukturat përkatëse në realizimin e këtyre objektivave | Prill 2022 | | QKB dhe DPT |

| | | | | | | |
|--|---|--------------|---|--------------|--|--|
| | Rritja e kapaciteteve monitoruese të KKK-së | Dhjetor 2022 | 1. Finalizimi i metodologjisë së monitorimit të pasqyrave financiare 2. Krijimi i njësisë së monitorimit, si një departament i veçantë brenda KKK-së, për të realizuar kërkesën e parashikuar në ligjin e kontabilitetit për monitorimin e zbatimit të SKK/SNRF-ve të aplikuara në hartimin e pasqyrave financiare | Shtator 2022 | Asistencë teknike dhe shtesa në organikë | |
|--|---|--------------|---|--------------|--|--|

4. Plani i punës për vitin 2022

Për vitin 2022, Këshilli, duke mbajtur në konsideratë prioritetet që burojnë nga ligji dhe ato që burojnë nga objektivat madhorë të Qeverisë, parashikon të angazhohet në përmbushjen e disa detyrave, ndër të cilat janë:

1. Përkthimi i SNRF-ve dhe përgatitja e variantit të konsoliduar
2. Faza e dytë e rishikimit të Udhëzuesve të SKK-ve (përfshirë udhëzime për plotësimin e shënimeve shpjeguese)
3. Rishikimi i SKK-ve (me objekt reflektimin në SKK-të e tjera të ndryshimeve të disa prej SKK-ve në vitet 2019-2021 si dhe tabelat koresponduese të paragrafëve të SKK-ve me paragrafët e SNRF-ve)
4. Krijimi i urave të ndërveprimit dhe angazhimi në projekte konkrete bashkëpunimi me QKB dhe DPT për:
 - *Caktimin e një sporteli të vetëm për dorëzimin e pasqyrave financiare;*
 - *Gjetjen e zgjidhjes teknike për publikimin e detyrueshëm të shënimeve shpjeguese;*
 - *Ndërtimin e një sistemi efektiv të mbikqyrjes së personit përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare;*
5. Miratimi i Kodit të Etikës të KKK-së;
6. Miratimi i metodologjisë së monitorimit të SKK-ve

Shtojcë A- Realizimi i treguesve të buxhetit dhe veprimtaria financiare për vitin 2021

Realizimi i Buxhetit të KKK-së për vitin 2021

